

FORMULARI NUMËR 3

KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Emri:	AGRON
Mbiemri:	BAJRAMI

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni si vijon:

I. Analizën tuaj:

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

Gjendja aktuale në Prokurorinë e Shtetit nga këndvështrimi dhe përvoja ime rreth 15 vjeçare në këtë institucion tregon nevojën për forcimin dhe ruajtjen e pavarësisë dhe integritetit të Prokurorisë nga ndikimet politike dhe presionet e jashtme.

Prokuroria shpesh has probleme me vonesat në procedura dhe administrimin e rasteve si pasojë e numrit të vogël të Prokurorëve, numrit të vogël të hetuesve policor, mosefikasitetit të policisë hetimore dhe institucioneve tjera ligjzbatuese.

Bazuar në vlerësimet vendore dhe ndërkombëtare shpesh përmendin nevojën për më shumë përpjekje në luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ka nevojë për të rritur kapacitetin e Prokurorisë për të hetuar dhe ndjekur penalisht këto raste.

Njëkohësisht konsideroj që ka nevojë për rritjen e transparencës në veprimtarinë e Prokurorisë, si dhe përmirësimin e mekanizmave të llogaridhënies. Prokuroria duhet të jetë më e hapur ndaj publikut dhe të ofrojë informacione më të plota për proceset e saj por çdo here duke ruajtur konfidencialitetin.

Bashkëpunimi me agjencitë e tjera ligjzbatuese mendoj që është një nevojë thelbore dhe forca e këtij bashkëpunimi mund të ndihmojë në adresimin e problemeve të krimit të organizuar, korrupsionit, shpërlarjes së parave dhe formave tjera të aktivitetit kriminal.

Gjithashtu konsideroj që është e nevojshme të ketë trajnime të vazhdueshme për prokurorët dhe stafin e Prokurorisë, për të rritur standardet profesionale dhe për të përmirësuar efektivitetin e punës.

2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë për të cilën keni aplikuar?

Pavarësisht numrit të madh lëndëve të pranuar në këtë Prokurori, afateve të shkurtëra ligjore të përcaktuara për zgjidhjen e këtyre lëndëve, numrit të vogël të prokurorëve e sidomos stafit mbështetës duke përfshirë bashkëpuntorët profesional dhe zyrtarët ligjor, Prokuroria e Apelit arrinë me sukses të përmbushë mandatin e vet ligjor në zgjidhjen e lëndëve në përputhje me standardet profesionale brenda afateve ligjore dhe në kohë të arsyeshme.

3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

Nga vlerësimi im si pjesë e kësaj Prokurorie si mangësi konsideroj si më poshtë:

- Mungesa e burimeve njerëzore - Numri i pamjaftueshëm i prokurorëve dhe stafit mbështetës ndikon në përmbushjen e detyrave dhe mandatit ligjor në kuptim të cilësisë së trajtimit të rasteve përball numrit të madh të lëndëve që ka për të trajtuar.

- Trajnimi i pamjaftueshëm i prokurorëve dhe stafit mbështetës (bashkëpunëtorve profesional dhe zyrtarëve ligjor) sidomos rreth procedurës ankimore dhe vendimarrjes në prokurorinë e apelit - shkakton mungesë në profesionalizëm dhe në aftësinë për t'u përballur me sfidat ligjore.

- Mungesa e infrastrukturës - shfrytëzimi i hapsirave të përbashkëta dhe të vogëla nga stafi mbështetës pengon efikasitetin, konfidencialitetin dhe trajtimin adekuat të lëndëve.

Ndërsa si sfida konsideroj:

- Afatet e shkurtëra ligjore - trajtimi dhe vendimarrja lidhur me çështjet që trajtohen nga Prokuroria e Apelit varësisht nga volumi është sfidë për shkak të afatit të shkurtër kohor

Ngarkesa e lartë e çështjeve - trajtimi i numrit të madh të lëndëve nga ana e prokurorëve ndikon në menaxhimin e rasteve për të shmangur vonesat.

- Rritja e transparencës dhe besueshmërisë - komunikimi dhe arsyetimi i vendimeve të nxjerrura për çështjet që i trajton Prokuroria e Apelit e që kanë ndikim të madh shoqëror janë sfidë për të fituar besimin e publikut.

- Lufta kundër korrupsionit dhe ruajtja e integritetit – zbatim i efikas i Kodit të Etikës për Prokuror dhe stafin mbështetës për të mbajtur standarde të larta etike dhe për të parandaluar ndikimet e jashtme.

- Bashkëpunimi ndërinstitucional - bashkëpunimi efektiv me të gjitha Prokuroritë Themelore, Prokurorinë Speciale, Gjykatën e Apelit dhe institucionet tjera për zbatimin e ligjit për një zgjidhje më efektive të çështjeve.

4. A mendoni se strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

Duke u nisur nga fakti që Prokurori i Shtetit dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) kanë zhvilluar strategji specifike për të përmirësuar sistemin e drejtësisë dhe për të adresuar sfidat aktuale (Strategjia kryesore për periudhën 2022-2024) e cila përfshinë Përmirësimin e Efikasitetit dhe Integritetit, Luftën kundër Krimit dhe Korrupsionit, Transparencën dhe Komunikimin me Publikun dhe Trajnimin dhe Zhvillimin Profesional të Prokurorëve, unë mendoj që i adresojnë mjaftueshëm nevojat e Prokurorisë së Apelit.

II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në prokurorinë që keni aplikuar?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?

Vizioni im për përmirësimin e punës operative të Prokurorisë së Apelit synon efikasitetin dhe transparencën në çdo nivel.

Në afat të shkurtër, do të përqendrohem në standardizimin e procedurave dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet departamenteve, për të siguruar që çështjet trajtohen me shpejtësi dhe saktësi.

Në afat të mesëm, do të angazhohem për përmirësimin e trajnimeve për stafin, duke u fokusuar në specializimin dhe profesionalizmin e prokurorëve për të adresuar çështjet më komplekse.

Në afat të gjatë, do të përpiqem të konsolidoj një kulturë të llogaridhënies dhe transparencës, duke ndërtuar një sistem mbikëqyrës dhe mekanizma të vlerësimit të performancës që përmirësojnë qëndrueshmërinë e rezultateve.

2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?

Nën udhëheqjen dhe menaxhimin tim synoj që t'i përmbushi këto objektiva kryesore:

- Zbatimin e udhëzimeve, rregulloreve, vendimeve, strategjive dhe planeve të veprimit të aprovuara nga ana e PSH-së dhe KPK-së;
- Menaxhimi i Prokurorisë së Apelit me tri departamentet e saj;
- Plani për administrimin efikas dhe efektiv të drejtësisë në Prokurori;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore (personeli i Prokurorisë së Apelit);
- Identifikimi i problemeve, si dhe propozimi për zgjedhjen e tyre;

3. Cilat janë sfidat që prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektiveve?

Gjatë përmbushjes së objektiveve të cekura më lartë, sfidat kryesore që mund të paraqiten përfshijnë:

1. **Mungesa e burimeve njerëzore** - Nuk mund të pritet sukcesi i punës së Prokurorisë nëse nuk ka burimet e mjaftueshme njerëzore, prandaj jo rrallë herë është potencuar dhe është paraqitur si shqetësuese mungesa e burimeve njerëzore dhe si rezultat i mungesës së stafit mund të paraqiten edhe ngecje në punë.
2. **Ngarkesa e punës** - Volumi i madh i rasteve mund të ndikojë në cilësinë dhe efikasitetin e zgjidhjes së rasteve.
3. **Vlerësimi i performancës** - Krijimi i një sistemi të qartë për vlerësimin e performancës kërkon angazhim të vecantë dhe të vazhdueshëm që të përmirësoj qëndrueshmërinë e rezultateve.
4. **Rritja e besimit në publik** - Edhe pse janë bërë përpjekje, është e rëndësishme të vazhdohet me angazhimin për transparencë dhe llogaridhënie.
5. **Identifikimi i problemeve** - Disa probleme mund të jenë të vështira për t'u identifikuar në mënyrë të shpejtë andaj kërkojnë vëmendje dhe angazhim të vazhdueshëm.

4. Si do t'i tejkalonit ato?

Për të tejkalar sfidat e identifikuar gjatë përmbushjes së objektiveve, do të kërkoj mbështetje nga KPK-ja. Rishikimi i proceseve të punës do të ndihmojë në identifikimin e mundësive për optimizim dhe në sigurimin e një shpërndarje më të barabartë të rasteve në vecanti të atyre rasteve të cilat nuk janë të regjistruara në sistemin digjital SMIL. Po ashtu, do të zhvilloj një sistem të qartë dhe transparent për vlerësimin e performancës, duke ofruar feedback të rregullt dhe mundësi për zhvillim profesional. Angazhimi për transparencë dhe llogaridhënie do të rrisë besimin e publikut, duke njoftuar publikun për aktivitetet e Prokurorisë përmes ëeb faqes së Sistemit Prokurorial. Së fundi, do të krijoj mekanizma të qartë për raportimin

dhe identifikimin e problemeve, duke inkurajuar Prokurorët të japin sugjerime dhe t'i adresojnë ato në mënyrë proactive. Këto strategji do të kontribuojnë në një ambient më efikas dhe produktiv në Prokurorinë e Apelit.

III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerren gjatë mandatit tuaj:

1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?

Modeli im në menaxhimin e stafit është i bazuar në performancë dhe bashkëpunim. Do të vendos objektiva të qartë dhe do të zhvilloj një sistem të vlerësimit të rregullt për të monitoruar përparimin. Një tjetër hap do të jetë ofrimi i mundësive të trajnimit dhe zhvillimit profesional, për t'i mbajtur prokurorët dhe stafin mbështetës të përditësuar me ligjet dhe praktikat më të mira.

Do të inkurajoj një kulturë të komunikimit të hapur, ku stafi mund të ndajë ide dhe shqetësime pa hezitur. Rishikimi periodik i strukturës së stafit do të ndihmojë në identifikimin e nevojave për burime të reja. Promovimi i etikës dhe integritetit do të jetë prioritet, për të forcuar besimin në sistem.

Në fund, do të nxis inovacionin dhe krijimtarinë, duke inkurajuar prokurorët dhe stafin mbështetës të kontribuojë me zgjidhje të reja për sfidat ekzistuese. Këto hapa do të kontribuojnë në krijimin e një ambienti efikas dhe të drejtë për të gjithë në prokurori.

2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?

Për të siguruar ndarjen e barabartë të punës, do të filloj me një vlerësim të kapaciteteve dhe përvojave të çdo njërit prej tyre. Pas kësaj, do të identifikoj secilin prej këtyre grupeve pune sipas arritjeve profesionale, shkencore dhe përvojave duke u siguruar që detyrat të shpërndahen në mënyrë të barabartë dhe të arsyeshme.

Do të implementoj një sistem të qartë të komunikimit për të diskutuar dhe rishikuar ngarkesat e punës në takime të rregullta. Përdorimi i teknologjisë për menaxhimin e rasteve SMIL-i do të ndihmojë në monitorimin e avancimit dhe përmbushjes së objektivave.

Inkurajimi i feedback-ut nga stafi do të jetë një hap tjetër, duke siguruar që çdo njëri të ndjehet i vlerësuar dhe i angazhuar. Në këtë mënyrë, do të krijoj një ambient pune ku secili ndihmon në arritjen e objektivave të përbashkëta.

3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

Për të përmirësuar llogaridhënien, do të implementoj një sistem të qartë vlerësimi që përfshin objektiva të matshme për secilin punonjës. Do të organizoj takime të rregullta për të diskutuar përparimin dhe për të ofruar feedback konstruktiv.

Një hap tjetër do të jetë zhvillimi i trajnimeve për etiken profesionale dhe standardet e punës, duke e theksuar rëndësinë e llogaridhënies individuale dhe kolektive. Do të krijoj mundësi për mentorim, duke lidhur prokurorët më të rinj me ata me më shumë përvojë, për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive profesionale.

Për më tepër, do të nxis një kulturë të komunikimit të hapur, ku stafi mund të ndajë shqetësimet dhe sugjerimet e tyre. Përdorimi i teknologjisë për monitorimin e performancës do të ndihmojë në sigurinë e llogaridhënies dhe transparencës. Këto hapa do të kontribuojnë në krijimin e një ambienti profesional dhe të përgjegjshëm.

IV. Hapat që do të ndërmerrni për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit, prokurorisë dhe besimit të publikut?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Çfarë hapash do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?

Për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurori duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës do të ndjek këto hapa:

Afatshkurtra:

- Krijimi i Politikave për Transparencën - do të zhvilloj një politikë të qartë që përcakton çfarë informacioni mund të publikohet dhe në cilat rrethana, duke garantuar transparencë pa cënuar konfidencialitetin.

- Raportim Periodik - publikimi i raporteve periodike mbi aktivitetet e prokurorisë, duke përfshirë statistikat mbi rastet e trajtuara dhe arritjet, për të informuar publikun.

Afatmesme:

- Komunikim Aktiv me Publikun - pjesëmarrja në takime dhe tryeza për të diskutuar çështjet e rëndësishme dhe për të marrë mendime dhe shqetësime nga qytetarët.
- Trajtimi i Ankesave - sigurimi që çdo ankesë të trajtohet në mënyrë të shpejtë dhe transparente, duke raportuar mbi procedurat dhe rezultatet.

Afatgjata

- Përputhshmëria me Ligjin - rritja e besueshmërisë duke siguruar që të gjitha veprimet e prokurorisë të jenë në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.

Këto hapa do të ndihmojnë në ndërtimin e një kulture besimi dhe transparence, duke ruajtur njëkohësisht konfidencialitetin e procedurave ku është e nevojshme.

2. Cilat janë planet tuaja për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?

Afatshkurtra:

- Vlerësimi i Strukturës Aktuale - kryerja e një analize të detajuar të kapaciteteve dhe nevojave të stafit për të identifikuar mangësitë dhe mundësitë për përmirësim.
- Përcaktimi i Standardeve të Cilësisë - hartimi i standardeve të qarta për punën e prokurorisë, që do të përfshijnë kriteret për shqyrtimin e rasteve dhe proceset e punës.

Afatmesme:

- Rishikimi i Procedurave të Monitorimit: Përdorimi i mekanizmave të monitorimit ekzistues për të vlerësuar cilësinë e punës, në përputhje me ligjin për prokurorin e shtetit, ligjin për Këshillin Prokurorial, Rregulloret, Udhëzimet e aktet tjera të Prokurorit të Shtetit, duke siguruar që të gjitha aktivitetet të përputhen me standardet e caktuara.

- Rritja e Bashkëpunimit me Këshillin Prokurorial - forcimi i marrëdhënieve me Këshillin Prokurorial për të siguruar mbështetje në zbatimin e procedurave dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve prokuroriale.

Afatgjata:

Fokusimi në Përshtatjen e Praktikave të Punës - angazhimi në një proces të vazhdueshëm për të përshtatur praktikat e punës dhe procedurat në përputhje me zhvillimet ligjore duke siguruar që prokuroria të jetë gjithmonë e gatshme për të përballuar sfidat e reja.

3. Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënies së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?

Për të përmirësuar llogaridhënien në Prokurorinë e Apelit, do të hartoj një plan të bazuar në disa shtylla kryesore:

- Transparenca Publike - synoj të publikoj raporte të rregullta për aktivitetet e prokurorisë, duke përfshirë statistika të trajtimit të lëndëve dhe ecurinë e rasteve. Kjo transparencë do të ndërtojë besim tek publiku dhe do të sigurojë qasje të vazhdueshme ndaj të dhënave mbi performancën por gjithnjë duke mos cenuar konfidencialitetin.

- Mekanizma të Qartë për Vlerësimin e Performancës - do të përforcoj dhe standardizoj sistemin aktual të vlerësimit të performancës për prokurorët dhe stafin mbështetës, bazuar në objektiva të qarta dhe indikatorë të matshëm. Ky mekanizëm do të ndihmojë në identifikimin e fushave për përmirësim dhe do të promovojë efikasitetin.


- Standarde Etike të Përmirësuara - pjesëmarrja në trajnime të vazhdueshme për etikën dhe llogaridhënien do të ndihmojë në forcimin e integritetit profesional. Synimi është të kultivohet një kulturë ku secili prokuror është i përgjegjshëm për veprimet dhe vendimet e tij.

- Bashkëpunimi me Palët e Interesit - do të promovoj bashkëpunimin me OJQ-të dhe grupet e interesit, duke marrë pjesë në diskutime të përbashkëta ku do të adresohen shqetësimet dhe sugjerimet e publikut. Ky angazhim do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve.

Këto masa do të sigurojnë një Prokurori të Apelit më të përgjegjshme, duke promovuar një kulturë transparence dhe besueshmërie në shërbim të ligjit dhe publikut.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij konceptdokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se i njëjti do të publikohet në uebportal.

Nënshkrimi: _____

A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke, positioned above a solid horizontal line.

Datë: 08.11.2024